



AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE GUSHT 2024

ADMINISTRATA DOGANORE E MBYLLI MUAJIN GUSHT ME 21,4 MILIARDE LKË - 1,7 MILIARDE LKË MË SHUMË SE GUSHTI 2023

Administrata Doganore e mbylli planin e muajit Gusht me realizimin 100%, ose 21,4 miliardë lekë. Krahasuar me Gushtin 2023 janë realizuar 1,7 miliardë lekë më shumë. Një rezultat fantastik ka dhënë importi i mallrave të akcizës, ku theksohet ai i karburantit i cili këtë muaj ka arritur shifrën 76,000 ton, një shifër e paimagjineshme vetëm një vit më parë. Krahasuar me muajin Gusht të vitit 2023 janë realizuar rreth 7,000 ton karburant më shumë, 20 ton cigare më shumë, 1,000 ton birrë më shumë dhe 150 ton kafe më shumë.



Për periudhën 8-mujore Janar-Gusht janë realizuar 153,7 miliardë lekë, ose 101% e planit me një plus në buxhetin e shtetit prej 1,3 miliardë lekësh, megjithëse janë humbur vetëm nga kursi i këmbimit 13 miliardë lekë, ose rreth 150 mln USD. Krahasuar me 8-mujorin 2023 janë realizuar 11,2 miliardë lekë më shumë, ose 108,3%. Mallrat e akcizës në këtë 8-mujor kanë patur një performancë të shkëlqyer, duke dhënë rreth 27,000 ton karburant më shumë, rreth 30 ton cigare më shumë, rreth 200 ton kafe më shumë dhe 2,200 ton birrë më shumë. Me trendin aktual, Administrata Doganore synon mbylljen e planit të të ardhurave 2024 me masën 101% dhe me një rezultat historik për sa i përket zhdoganimeve të mallrave të akcizës.



MINISTRI I FINANCAVE DHE DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE VIZITOJNË PORTO ROMANON PËR TË MONITORUAR ZBATIMIN E PLANIT OPERACIONAL PËR KONTROLLIN E HIDROKARBUREVE

Ministri i Financave, Z. Petrit Malaj i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, zhvilluan një vizitë në ambientet e portit të karburanteve në Porto Romano, për të parë nga afër zbatimin e Planit Operacional mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Të tre institucionet kanë nënshkruar dhe po zbatojnë Planin Operacional 24/7 për të koordinuar dhe bashkëpunuar ngushtë për shkëmbimin dhe trajtimin e informacionit, për kontrollin e veprimtarisë së importit, eksportit, prodhimit, depozitimit, transportimit dhe tregtimit të hidrokarbureve. Plani i përbashkët operacional ka synim kontrollin dhe monitorimin e importit, mbajtjes dhe tregtimit të produkteve energjetike të akcizës për zbatueshmëri dhe legjislacionit në fuqi. Për periudhën 7 mujore 2024 konsumi i karburanteve arriti në 381,083 tonë me rritje 19,700 tonë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 kur ishin 361,381 tonë.



FLUKS NË PIKAT E KALIMIT KUFITAR NË MURIQAN DHE HANIN E HOTIT

Muaji Gusht shënoi fluks të shtuar lëvizjesh të qytetarëve në pikat e kalimit kufitar në Muriqan dhe Hanin e Hotit. Mbi 32 mijë shtetas kanë kaluar mesatarisht në 24 orë në këto dy pika doganore, ndërsa punonjësit e administratës doganore përballuan me profesionalizëm ngarkesën duke shmangur radhët në dy pikat lidhëse të Shqipërisë me Malin e Zi.



FLUKSI I PASAGJERËVE NË DURRËS, DREJTORI GAZHELI TAKON PUNONJËSIT E DOGANËS PORTUALE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli ishte në Portin e Durrësit, ku fluksi i vizitorëve gjatë muajit gusht ka qenë mjaft i lartë. Pas aeroportit të Rinasit, Porti i Durrësit ishte një ndër pikat kryesore hyrëse të turistëve këtë sezon veror duke regjistruar shifra rekord. Mbi 85 mijë qytetarë kanë mbërritur në këtë port përmes porteve italiane vetëm gjatë muajit korrik.



FLUKS PASAGJERËSH NË DOGANËN E KAKAVIJËS, MBI 10 MIJË SHTETAS HYNË ÇDO DITË NË VENDIN TONË

Në pikën kufitare të Kakavijës vazhdoi fluksi i lëvizjes në të dyja anët e kufirit me Greqinë gjatë muajit Gusht. Nga administrata doganore është punuar me kapacitet të plotë për përpunimin e dokumentave të udhëtarëve për të evituar radhët e gjata. Fluksi mesatar i lëvizjes gjatë 24 orëve në këtë pikë doganore ka arritur në mbi 10 mijë shtetas, si dhe në afro 3400 automjete.



DREJTORI I DOGANAVE NË MORINË: VËMENDJE TË SHTUAR DHE ETIKË PROFESIONALE NGA ÇDO PUNONJËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli zhvilloi një vizitë në degën doganore të Morinës. Gjatë takimit me punonjësit e kësaj dege, ai falenderoi stafin për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në përbalimin e fluksit të udhëtarëve që këtë sezon turistik ka arritur kulmin me mbi 4.5 milionë qytetarë dhe afro 1.4 milionë mjete që kanë kaluar kufirin nga muaji Qershor deri në fund të Gushtit. Drejtori Gazheli kërkoi përgjegjshmëri, vëmendje të shtuar dhe etikë profesionale nga çdo punonjës i Administratës Doganore në përbalje me qytetarët dhe angazhimim maksimal gjatë muajve në vijim ku pritet të vijojë fluksi i udhëtarëve.



VIJON FLUKSI I UDHËTARËVE NË PIKËN DOGANORE TË QAFË BOTËS

Në pikën doganore të Qafë Botës vijoi fluksi i udhëtarëve në ditët e ndërsa të gushtit. Punonjësit e administratës doganore iu përgjigjën me përkushtim dhe profesionalizëm qytetarëve që zgjedhën këtë pikë të kalimit kufitar.



A E DINI SE?

Mallrat që përjashtohen për nxënësit dhe studentët:

- Uniformat shkollore si veshmbathje, shtresa shtëpiake, veshje të reja ose jo;
- Materialet e studimit, si dhe sende, instrumenta ku përfshihen makinat llogaritëse, makinat e shkrimit dhe çdo send tjetër që zakonisht përdoret për nevojat e studimeve;
- Pajisje shtëpiake që përbëjnë në vetvete materiale të zakonshme për dhomat studentore dhe që u përkasin dhe u nevojiten atyre për përdorim vetjak gjatë kohës së studimeve të tyre.



DOGANA DIGJITALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit Gusht 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar 476 shërbime online.

Kriteret për të përfituar përjashtim: Nxënësi ose studenti duhet të jetë i regjistruar në një institucion edukimi për të ndjekur me kohë të plotë mësimet e ofruara në këtë institucion.

KUJDES... Përjashtimi lejohet të paktën njëherë për çdo vit shkollor.